

LIGJ
Nr. 90/2021

PËR NDARJEN E SHOQËRISË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ndarja e shoqërisë hekurudhore shtetërore

1. Shoqëria “Hekurudha shqiptare” sh.a. (HSH), ndahet në katër shoqëri pritëse si më poshtë:
 - a) Shoqëria Aksionare për Infrastrukturën Hekurudhore, në vijim Administruesi i Infrastrukturës;
 - b) Shoqëria Aksionare Hekurudhore për Transportin e Udhëtarëve, në vijim Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve;
 - c) Shoqëria Aksionare Hekurudhore për Transportin e Mallrave, në vijim Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit;
 - ç) Shoqëria Aksionare Hekurudhore për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse në vijim Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore.
2. E drejta e pronarit të shoqërive të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni ushtrohet nga ministria përgjegjëse për ekonominë.
3. Regjistrimi i shoqërive pritëse bëhet në përputhje me Kodin Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përgjegjësitë e Administruesit të Infrastrukturës

1. Administruesi i Infrastrukturës është shoqëria aksionare përgjegjëse për funksionimin, mirëmbajtjen, rindërtimin dhe rinovimin e infrastrukturës në rrjetet e transportit.
2. Administruesi i Infrastrukturës administron, menaxhon dhe kryen kontrollin e brendshëm të infrastrukturës në kuadër të politikës së zhvillimit dhe financimit të infrastrukturës hekurudhore kryesore.
3. Administruesi i Infrastrukturës ndan kapacitetet, mbledh tarifa dhe propozon për rishikimin e tyre dhe ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për:
 - a) zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore nëpërmjet planifikimit të rrjetit, me plan financiar për investime në ndërtim dhe përmirësim të infrastrukturës;
 - b) funksionimin e infrastrukturës hekurudhore për ndarjen e rrugëve të kalimit të trenave, menaxhimin e trafikut dhe tarifimin e përdorimit të infrastrukturës;
 - c) mirëmbajtjen rutinë, parandaluese dhe atë korrigjuese të infrastrukturës hekurudhore nëpërmjet punimeve që synojnë të mirëmbajnë gjendjen dhe aftësinë e infrastrukturës ekzistuese;

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

Direktivën 2012/34/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 21 nëntor 2012, “Për krijimin e një zone të vetme hekurudhore evropiane”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32012L0034, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 343, datë 14.12.2012, f. 32–77.

ç) rinovimin e infrastrukturës hekurudhore nëpërmjet punimeve kryesore të zëvendësimit të infrastrukturës ekzistuese, të cilat nuk ndryshojnë performancën e saj të përgjithshme;

d) modernizimin e infrastrukturës hekurudhore nëpërmjet punimeve të mëdha modifikuese në infrastrukturë, që përmirësojnë performancën e përgjithshme të saj;

dh) funksionet thelbësore të menaxhimit të infrastrukturës, që nënkupton vendimmarrjen në lidhje me ndarjen e rrugëve të kalimit të trenit, duke përfshirë edhe përkufizimin dhe vlerësimin e disponueshmërisë dhe dhënien apo alokimin e rrugëve të trenave individualë, dhe vendimmarrjen në lidhje me tarifimin e infrastrukturës, përfshirë përcaktimin dhe mbledhjen e tarifave në përputhje me kornizën e tarifimit dhe kornizën e ndarjes së kapaciteteve në konformitet me Kodin Hekurudhor;

e) ofrimin e impianteve të shërbimit në mënyrë jodiskriminuese, të barabartë dhe transparente për të gjithë sipërmarrësit e licencuar hekurudhorë, në përputhje me pikat 1 dhe 4 të nenit 15 të Kodit Hekurudhor;

ë) jetësimin dhe zbatimin e projekteve hekurudhore kombëtare dhe rajonale në rrjetet transeuropiane (TEN-T).

2. Për menaxhimin e aseteve të infrastrukturës hekurudhore lidhet kontratë me autoritetin kompetent, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e administruesit të infrastrukturës për një afat kohor prej të paktën katër vjetësh.

3. Administruesi i infrastrukturës është përgjegjës për garantimin e specifikimeve teknike për ndërveprimin hekurudhor.

4. Administruesi i Infrastrukturës mat, përmirëson dhe monitoron performancën e funksionimit të kapaciteteve infrastrukturore dhe kulturës së sigurisë hekurudhore.

5. Administruesi i Infrastrukturës garanton miradministrimin e sistemeve të planit të menaxhimit të aseteve të pasurive infrastrukturore.

6. Administruesi i Infrastrukturës me ministrin përgjegjës për infrastrukturën lidhin kontratë shumëvjeçare të parametrave teknikë infrastrukturore hekurudhorë.

Neni 3

Përgjegjësitë e Sipërmarrësit Hekurudhor të Transportit të Udhëtarëve

1. Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve është përgjegjës për administrimin, funksionimin e shërbimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të transportit hekurudhor të udhëtarëve, nëpërmjet lokomotivave dhe vagonëve të udhëtarëve, të blera ose të marra me qira, duke garantuar:

a) performancën e lartë të këtij lloj transporti;

b) miradministrimin e aseteve të mjeteve lëvizëse.

2. Ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve lidhin kontratën e shërbimit publik për të garantuar që ky shërbim me interes të përgjithshëm të ofrohet me kapacitet sa më të lartë, të jetë sa më i sigurt, sa më cilësor ose i ofruar me çmime më të ulëta sesa ato të tregut të hapur.

3. Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve mund të jetë përfituesi i të drejtës ekskluzive për të ofruar shërbimin publik për transportin e udhëtarëve me hekurudhë.

4. Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve është përgjegjës për mirëmbajtjen e regjistrit të mjeteve ku është shënuar edhe sipërmarrësi përgjegjës për mirëmbajtjen e mjeteve të tij.

Neni 4

Përgjegjësitë e Sipërmarrësit Hekurudhor të Transportit të Mallrave

Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallrave është përgjegjës për administrimin, funksionimin e shërbimeve kombëtare dhe ndërkombëtare hekurudhore të transportit të

mallrave dhe mjeteve të kombinuara të transportit, në kuptimin e transportit multimodal, nëpërmjet lokomotivave dhe vagonëve, të blerë ose të marrë me qira, duke garantuar:

- a) kryerjen e transportit të mallrave;
- b) rregullimin ligjor të transportit hekurudhor të mallrave;
- c) miradministrimin e regjistrave të mjeteve dhe planit të aseteve të mjeteve tërheqëse dhe lëvizëse.

Neni 5

Përgjegjësitë e Sipërmarrësit të Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore

1. Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore është përgjegjës për modernizimin, riparimin, përmirësimin, rinovimin dhe rindërtimin e elementeve përbërës të ndërveprimit të mjeteve hekurudhore tërheqëse dhe lëvizëse, të rënda dhe të lehta.

2. Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore është përgjegjës për mirëmbajtjen e asaj infrastrukture që i përket planit të aseteve të administruar prej tij, si dhe të objekteve të destinuara për ofrimin e shërbimeve hekurudhore dhe shërbimeve të tjera nëpërmjet:

- a) realizimit të ndërveprimit si aftësi e sistemit hekurudhor për të lejuar përdorim të sigurt dhe të pandërprerë të mjetit hekurudhor, që përmbushin nivelet e kërkuara të performancës për ato linja;
- b) garantimit të standardeve europiane dhe ndërkombëtare të harmonizuara në atë shqiptare për zbatimet hekurudhore, pas rindërtimit të mjetit hekurudhor, i cili do të pajiset me autorizim për futjen në shërbim të mjetit;
- c) lëshimin e faturave për shërbimet për të tretët dhe mbledhjen e tarifave të këtyre shërbimeve nga subjekti përgjegjës i certifikuar për mirëmbajtjen e mjetit hekurudhor.

Neni 6

Procedura e krijimit të shoqërive aksionare hekurudhore

1. Ministria përgjegjëse për ekonominë realizon ndarjen e shoqërisë jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

2. Me kryerjen e kësaj procedure aktivet dhe pasivet e shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a., transferohen te shoqëritë pritëse.

3. Procesi i ndarjes bëhet në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

4. Shoqëria “Hekurudha shqiptare” sh.a., vlerësohet e prishur dhe çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit pa kryerjen e likuidimit.

5. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit pasohet me:

- a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim pasqyrohet edhe në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
- b) bërjen e aksionarëve të shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a, në aksionarë të shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes.

6. Në ditën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, shoqëria e infrastrukturës hekurudhore, shoqëria e transportit të pasagjerëve, shoqëria e transportit të mallrave dhe shoqëria e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse bëhen administrues të aseteve që i janë alokuar secilës prej tyre në veçanti.

7. Pasuritë e shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a., ndahen dhe i alokohen si pronësi në administrim të katër shoqërive të reja, që krijohen përmes akteve të veçanta dhe të drejtpërdrejta të transferimit të pronësisë, midis ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në emër të Republikës

së Shqipërisë, dhe përkatësisht, shoqërisë së infrastrukturës, shoqërisë së transportit të pasagjerëve, shoqërisë së transportit të mallrave dhe shoqërisë së mirëmbajtjes.

8. Përrjashtim nga dispozitat e përmendura në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, do të ketë për ndërtesat e biznesit, në veçanti stacionet e pasagjerëve dhe терминаlet e mallrave dhe ndërtesat e tjera, pasuritë e të cilave shfrytëzohen kryesisht për interes publik. Ato i ngarkohen për menaxhim Administruesit të Infrastrukturës, me qëllim nxitjen e konkurrencës midis sipërmarrjeve hekurudhore dhe zhvillimit të transportit multimodal të udhëtarëve dhe mallrave dhe sigurimit të aksesit të drejtë dhe jodiskriminues nga palët e treta.

9. Të gjitha pasuritë e tjera që nuk lidhen me veprimtaritë e biznesit të katër shoqërive i atribuohen Administruesit të Infrastrukturës, që i menaxhon sipas parimeve të biznesit.

10. Organet drejtuese të shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a., në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe ministrinë përgjegjëse për financat, hartojnë planin social që përcakton rregullat se cilët nga punonjësit e shoqërisë do të jenë:

- a) të punësuar;
- b) të liruar nga puna për shkak riorganizimi të shoqërive.

11. Plani social përcakton edhe ndarjen e përfitimeve sociale sipas legjislacionit në fuqi midis shoqërive pritëse.

Neni 7

Statusi i shoqërive pritëse dhe menaxhimi i tyre

1. Shoqëritë pritëse do të administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

2. Shoqëritë pritëse ushtrojnë aktivitetet e tyre në treg duke synuar ofrimin e shërbimeve efikase dhe të përshtatshme me koston më të ulët të mundshme për cilësinë e shërbimit të kërkuar.

3. Shoqëritë pritëse përditësojnë planet e masave të mitigimit të risqeve dhe regjistrat.

4. Shoqëritë pritëse përcaktojnë planet e tyre të biznesit, përfshirë programet e tyre të investimit dhe të financimit. Planet hartohen për të arritur ekuilibrin financiar të shoqërisë dhe objektivat e tjerë teknikë, tregtarë dhe të menaxhimit financiar, duke treguar mënyrat e arritjes së këtyre objektiveve.

5. Në përputhje me planet dhe kontratat kombëtare, duke përfshirë planet e investimeve dhe të financimit, shoqëritë pritëse, veçanërisht, janë të lira të:

- a) krijojnë organizimin e tyre të brendshëm;
- b) kontrollojnë furnizimin dhe tregtimin e shërbimeve dhe rregullojnë çmimin e tyre;
- c) marrin vendime për personelin, asetet dhe prokurimet e veta;
- ç) zgjerojnë pjesën e tyre të tregut, zhvillojnë teknologji të reja dhe shërbime të reja dhe adoptojnë çdo teknikë inovative të menaxhimit;
- d) krijojnë aktivitete të reja në fushat që lidhen me biznesin hekurudhor.

6. Pavarësisht nga parashikimi i pikës 4 të këtij neni, aksionarët e sipërmarrjeve hekurudhore në pronësi publike ose të kontrolluara kërkojnë miratimin e tyre paraprak për vendimet kryesore të administrimit të biznesit në të njëjtën mënyrë si aksionarët e shoqërive aksionare private, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin tregtar.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e aksionarit të shoqërive

Në bazë të përcaktimeve të neneve 6 dhe 7 të këtij ligji, ministri përgjegjës për ekonominë përcakton të drejtat dhe detyrimet që ka si aksionar i shoqërive pritëse dhe, në veçanti, për sa i përket:

- a) kuadrit politik të të katër shoqërive aksionare si aktorë të rinj në sektorin hekurudhor të ristrukturuar;
- b) mekanizmat për reduktimin e borxheve të katër kompanive aksionare në një nivel që nuk pengon menaxhimin e shëndoshë financiar dhe që përmirëson situatën e ardhshme financiare, siç parashikohet në Kodin Hekurudhor në fuqi;
- c) aksionarët dhe përgjegjësitë e financimit për katër shoqëritë aksionare, me qëllim mbulimin e humbjeve të ardhshme që mund të lindin nga kryerja e përgjegjësisë të përcaktuara në nenet 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji;
- ç) përzgjedhjen e këshillave mbikëqyrës të katër shoqërive aksionare, duke siguruar që të njëjtët individë nuk mund të emërohen në këto raste:
- i. si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të një Administruesi të Infrastrukturës dhe si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të një sipërmarrjeje hekurudhore;
 - ii. si persona përgjegjës për marrjen e vendimeve për funksionet thelbësore dhe si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të një sipërmarrjeje hekurudhore;
 - iii. kur ekziston një këshill mbikëqyrës, si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të një Administruesi të Infrastrukturës dhe si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të një sipërmarrjeje hekurudhore;
 - iv. si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të një sipërmarrjeje, e cila është pjesë e një sipërmarrjeje të integruar vertikalisht dhe ushtron kontroll si për një sipërmarrje hekurudhore, ashtu edhe për një menaxher të infrastrukturës dhe si anëtarë të këshillit mbikëqyrës ose organeve drejtuese të atij Administruesi të Infrastrukturës.
- d) përzgjedhjen e Komitetit të Auditimit.

Neni 9 **Dispozita të fundit**

1. Shoqëria “Hekurudha shqiptare” sh.a., çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit jo më vonë se gjashtë muaj pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të katër shoqërive pritëse.
2. Shoqëritë pritëse janë pasardhëset ligjore të shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a., për sa i përket transferimit të pasurive dhe të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të tjera.
3. Deri në ditën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të katër shoqërive pritëse, shoqëria “Hekurudha shqiptare” sh.a., mban të gjitha përgjegjësitë për administrimin e infrastrukturës hekurudhore dhe shërbimeve të transportit hekurudhor.
4. Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve, Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallrave dhe Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore aplikojnë për licencat përkatëse, certifikatat dhe lejet e tjera në përputhje me përcaktimet në Kodin Hekurudhor në fuqi, jo më vonë se 180 ditë nga dita e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
5. Administruesi i Infrastrukturës aplikon për licencë dhe autorizim të sigurisë hekurudhore sipas Kodit Hekurudhor.

Neni 10 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 1.7.2021.